



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **20.01.2025**, me fillim në orën **10:15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuari nënkryetar i Komunës, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm! E hapim mbledhjen e **parë (1)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së Rahovecit, për vitin 2025;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar janar – dhjetor 2024;
4. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023;
5. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024;
6. Shqyrtimi i informatës rreth punës së KKSB-së për vitin 2024;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, P- 05864-0 dhe 05865-0, ZK – Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës P- 05865-0 dhe 05865-0 , ZK – Rahovec;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, P-00597-6, ZK – Xërxë;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës P-00597-6, ZK – Xërxë;
11. Shqyrtimi i raportit të punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024;
12. Shqyrtimi i raporti vjetor rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;

13. Të ndryshme.

Shtesë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për këmbimin e pronave komunale me pronat e institucionit qendror.

Kryesuesi: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot, por, dua t'ju informoj që kemi edhe një pikë shtesë. Pika shtesë ka të bëjë me pëlqimin për këmbimin e parcelave në zonën kadastrale Petkoviç dhe Kramovik, sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë.

Afrim Oruçi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së! Bazuar në kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Usaid-it, sepse ata e menaxhojnë këtë procedurë që ka të bëjë me parkun solar. Në vitin 2024, në muajin e 11-të, e kemi marrë një vendim dhe i kemi shpallur interes të përgjithshëm pjesët e parcelave që menaxhohen nga Ministria e Ekonomisë dhe kemi marrë vendim që t'i ndajmë pjesët e parcelave që janë pronë të komunës. E kemi pritë ligjshmërinë e këtyre vendimeve, ka kaluar 15-ditëshi dhe sipas përfaqësuesve të Ministrisë së Ekonomisë dhe të USAID-it, ata e kanë marrë përsipër që vetë të kontaktojnë me zyrtarë të MAPL-së. Prej neve kanë kërkuar që t'i dërgojmë direkt në kuvend, për shkak të afateve ligjore që i kanë të përcaktuara për t'u pajisur operatori me leje. Kjo është arsyeja që para jush nuk kemi material dhe kërkojmë që të futet si pikë shtesë në rend dite.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Drejtor, ministria nuk e ka gati materialin apo ju nuk keni arritur ta bëni gati? Në seancë, a do të vjen materiali për shkëmbimin e pronave? Nëse nuk është as në seancë, kjo mund të jetë çështje e juaja, por nuk mund të votohet diçka, pa e pasur një dokument përpara. Nuk po them ta ndalim, sepse është një proces të cilit i kemi dhënë dritë jeshile një seancë më herët, por, nëse nuk ka material në seancë më duket jonormale të thoni: "votoni diçka që na thanë"! Ju kërkoj falje që po shprehem kështu, por, materialin duhet ta kemi patjetër për atë pikë të rendit të ditës që duhet të votohet, qoftë pikë shtesë apo e rregullt.

Afrim Oruçi: Për këto dy vendimet që janë marrë në kuvend në muajin e 11-të të vitit 2024, materiali me kohë është proceduar për ligjshmëri në MAPL, mirëpo nuk na ka ardhur ligjshmëria për këto dy akte. Tani këtë obligim e kanë marrë përsipër përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe të USAID-it. Prej juve kërkojmë që veç ta vendosim në rend dite dhe ju garantojmë që sot ose nesër do ta keni materialin për këtë pikë, për kuvend.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, pikën shtesë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht votohet pika shtesë. Tani e vendosim në votim të gjithë rendin e ditës. Kush është "për"?... Kundër?... Me shumicë votash, votohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme të KPF-së.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash, votohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së Rahovecit, për vitin 2025:

Nënkryetari: Faleminderit i nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së! Para vetës keni propozim-vendimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës sonë. Në pikën dy të propozim-vendimit i keni specifikacionet e shërbimit që ofrohen nga bashkësia fetare në rastin e vdekjes. Ndryshimi nga ky vendim, prej vendimeve të mëhershme është në vlerë. Vendimi i ri për mbulimin e një varrimi është 280€, më herët ka qenë 220€.

Defrim Kafexhiu: Këtë vendim nuk e kemi në email!

Nënkryetari: Kërkoj falje në emër të sekretarisë së kuvendit, nëse vendimi nuk ka ardhë në emailt tuaja. Ky është vendim që përsëritet çdo vit. Besojmë që është një ndër shërbimet më të mira, në rastin kur në një familje ndodh një mort.

Skender Hamza: Sapo e pashë që ky propozim-vendim nuk është i bashkëngjitur. Kam qenë në pushime vjetore dhe ndoshta ka ndodhur ndonjë gabim teknik.

Kryesuesi: Nëse nuk keni diçka tjetër, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash, votohet pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar, janar – dhjetor 2024:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së! Fillimisht, ju kërkoj falje për vonesën e raportit, sepse nuk kemi pasur mundësi të barazohemi me Ministrinë e Financave dhe në momentin e barazimit ne ju kemi dërguar raportin menjëherë. Kërkoj falje gjithashtu që për shkak të kësaj gjendjeje, mund të ndodh që ndoshta ka rrjedhur ndonjë gabim teknik. Raporti financiar vjetor 2024, përfshin të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet financiare të cilat janë zhvilluar në kuadër të komunës së Rahovecit. Ky raport përbëhet nga pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit, pjesa e kontratave të lidhura, obligimet financiare dhe në fund janë edhe shpenzimet komunali. Do t'ju shpjegoj disa të dhëna bazike: Të hyrat në total janë 1.847.000€ dhe kur bëjmë krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi një rritje prej 57.815€. Këtu është fjala për të hyrat e rregullta, pa gjoba të gjykatave dhe të trafikut. Deri më tani, akoma nuk e kemi raportin e gjobave të gjykatave dhe të trafikut për 3-mujorin e fundit. Buxhetin kemi arritur ta shpenzojmë në total 22.638.000€ apo 99.24%. Raporti i ka të përfshira edhe të gjitha kontratat që janë lidhur në kuadër të zyrës së prokurimit. Pastaj, në raport i kemi obligimet financiare të kategorisë mallra dhe shërbim, si dhe obligimet e kategorisë së investimeve kapitale. Këto ishin disa informata bazë të këtij raporti. Pres pyetje!

Burim Krasniqi: Drejtor, te shpenzimet, te paga dhe mëditje janë diku 1.3 milionë më tepër shpenzime, sesa realizime. Mbi bazën e asaj që e kemi parë në komunë, kjo diferencë ka të bëjë me shpenzimin e kontratës kolektive, të cilat janë tërhekur nga procedura përmbarimore dhe janë kompensuar nga qeveria për mos të lejohet deficitin në paga. Kërkesë e imja është që raporti financiar ta ketë edhe një pjesë shtesë, pra, të ndahet pjesa e marrë në procedurë përmbarimore te pagat dhe mëditjet, si pasojë e kontratës kolektive.

Afrim Limani: Burim, nëse të kujtohet në seancën e nëntorit ose tetorit, duke raportuar për obligimet kontraktuale, si pikë e rendit të ditës ka qenë bartja e mjeteve për mbulimin e pagave. Do të thotë në nëntor nuk kemi mundur ta mbulojmë për 270.000€ dhe atje kanë qenë 900.000 dhe shkurt 1.400.000€ e kemi paguar pozicionin e pagave – konkretisht, thesari. Kjo i bie që ne i kemi shpëtuar 1.4 milionë€.

4. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023:

Afrim Limani: Ky është raporti i fundit që e kemi bërë gati për zbatimin e rekomandimeve për ZKA-në. Kemi mbajtur shumë takime, bashkë me komisionin për zbatimin e rekomandimeve dhe në bazë të konstatimit në cilësi të drejtorit, konsideroj që ky raport nga 8 rekomandime, besoj që plotësisht do të zbatohen 6 rekomandime dhe 2 pjesërisht.

5. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024:

Skender Hamza: Përshëndetje kryesues! Përshëndetje nënkryetar, ekzekutiv dhe anëtarë të KPF-së! Me kënaqësi po e paraqes raportin 12-mujor të punës së kuvendit të komunës së Rahovecit për vitin 2024. Raporti ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënien, karshi qytetarëve të komunës. Kuvendi i komunës i ka të themeluar 5 komitete, 2 janë obligative, 2 konsultative dhe gjithashtu e ka të themeluar edhe KKSB-në. Kuvendi i komunës së Rahovecit gjatë vitit 2024 i ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, 2 solemne dhe 1 mbledhje përkujtimore. KPF-ja po ashtu i ka mbajtur 12 mbledhje, Komiteti për Komunitete - 6 mbledhje, Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara – 6 mbledhje, Komiteti për Shëndetësi – 6 mbledhje dhe Komiteti për Arsim - asnjë mbledhje. Të gjitha mbledhjet e kuvendit dhe të komiteteve kanë qenë të hapura për publikun. Në mbledhjet e rregullta gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar 141 pika të rendit dhe janë aprovuar 77 vendime, 20 raporte dhe 20 informata. Ne, si sekretari e kuvendit, i kemi dërguar në MAPL 77 akte që janë marrë nga kuvendi i komunës së Rahovecit dhe numri i konfirmimit të ligjshmërisë është 58, si dhe nga këto 58, 10 vendime janë rishqyrtuar, duke u bazuar në rekomandimet e MAPL-së.

Burim Krasniqi: Skender, e the që po e pasqyrojmë punën e kuvendit në raport me qytetarët. Këtu është mirë ta kemi edhe prezencën e asambleistëve, si obligim që e kanë karshi qytetarëve. Le të jetë një tabelë për të gjithë, sa herë kanë munguar.

6. Shqyrtimi i informatës rreth punës së KKSB-së për vitin 2024:

Skender Hamza: Në mungesë të kryetarit, po e prezantoj këtë raport, pasi jam edhe koordinator i KKSB-së. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i ka mbajtur gjithsej 7 mbledhje të rregullta dhe një mbledhje urgjente. Përveç diskutimeve të cilat janë bërë duke u bazuar në pika të rendit të ditës, gjatë mbledhjeve janë marrë edhe konkluzione të ndryshme nga kryetari. Besoj që informata shtesë do të keni nga kryetari, në mbledhjen e rregullt të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, P- 05864-0 dhe 05865-0, ZK – Rahovec:

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! Bëhet fjalë për një vendim, për dhënien e një prone me qira për 15 vjet. Prona është në Rahovec, janë dy parcela: P- 05864-0 dhe 05865-0. Parcela e parë i ka 20 ari e 31m² dhe parcela e dytë i ka 3 ari e 20m². Parcelat janë në kufi me njëra-tjetrën. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është kultivimi i bujqësisë dhe blegtorisë.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës P- 05865-0 dhe 05865-0, ZK – Rahovec:

Afrim Oruqi: I ftoj anëtarët e KPF-së që ta votojnë pikën e shtatë dhe të tetën, e cila ka të bëjë me formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim, për parcelat e lartcekura.

Burim Krasniqi: Drejtor, kur po e hapim në gjeoportali, po na jep një parcelë pak çuditshëm! A është gjeoportali gabim, apo numri i parcelës? Cili është interesi që kjo të jepet me qira. Parcela nuk ka dalje në rrugë dhe është në fund të një parcele tjetër. A planifikohet t'i jepet dikujt që e ka arën në krye?

Afrim Oruqi: Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi: Kjo parcelë dhe parcelat e tjera, jo çdo parcelë ka rrugë kadastrale për dalje. Bazuar në kërkesat e palëve që kanë shprehur interesim, për shkak të specifikave që kjo parcelë i ka, mendojnë që është e përshtatshme për kultivimin e çajit. Kjo është ideja.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Do t'i vendosim në votim një nga një! Atëherë, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... 4 “për” dhe 1 abstenim, votohet pika e shtatë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e tetë, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 4 vota “për” dhe 1 abstenim, votohet edhe pika e tetë.

8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale P-00597-6, ZK – Xërxë:

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për parcelën në zonë kadastrale në Xërxë me numër 00597-6, me sipërfaqe të përgjithshme 21 ari e 95 m² e klasës së pestë. Qëllimi ka të bëjë me kultivimin e bujqësisë dhe të blegtorisë. Ju kërkohet që të marrim vendim, që këtë parcelë ta japim për 15 vjet.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës P-00597-6, ZK – Xërxë:

Afrim Oruqi: Paraprakisht, ju lus ta votoni edhe pikën e dhjetë, që ka të bëjë me komisionin për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim për të njëjtën parcelë.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Do t'i vendosim në votim një nga një edhe këtu! Atëherë, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash, votohet pika e nëntë. Vazhdojmë me pikën e dhjetë të komisionit. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash, votohet edhe pika e dhjetë.

11. Shqyrtimi i raportit të punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024:

Senad Mullaavda: Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin dhe anëtarët e KPF-së! Pranë jush e keni raportin vjetor të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, i cili bazohet në ligjin administrativ dhe në plan të punës. Brenda vitit 2024 janë mbajtur gjithsej 13 mbledhje, 12 të rregullta dhe 1 e jashtëzakonshme. Në muajin prill janë mbajtur dy mbledhje, e rregullta dhe e jashtëzakonshme. E jashtëzakonshme është mbajtur për çështjen e pëlqimit për implementimin e projektit të shtrirjes së ujit të pijes për fshatrat: Hoçë e Madhe, Zoqisht, Oplotushë – Zona Ekonomike. Kërkoj falje për mungesën e anëtarëve, të cilët mungesën po e arsyetojnë me probleme private dhe me kremtet e fillimvitet. Besoj që në mbledhje të Kuvendit do të vijë. Sfidë e këshillit mbetet buxheti i pamjaftueshëm.

12. Shqyrtimi i raportit vjetor rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024:

Kryesuesi: Në mungesë të kryesuesit të Komitetit për Komunitete, nëse jeni të pajtimit, prezantimi do të bëhet në mbledhjen e rregullt të Kuvendit.

13. Të ndryshme:

Burim Krasniqi: Është hera e tretë që po e përsëris të njëjtën kërkesë! I kam bërë dy pyetje, në njërin prej tyre është përgjigjur në format ndryshe, drejtori për zhvillim ekonomik. Kam kërkuar tri projektet që janë të gjetura në raportin e auditorit, si përfituese në procedurën 20% sipas planit dinamik. Kam bërë pyetje për informatë qoftë publike, qoftë personale. Në procedurë të konkurrimit, kompania fituese a ka qenë më e lira, e dyta apo më poshtë? Një pyetje tjetër: Cila ka qenë arsyeja që një ton pelet është paguar 370€ për furnizim të shkollave?


Defrim Kafexhiu: Faleminderit! Unë e kam vetëm një vërejtje për drejtorët e drejtorive. I vetmi drejtor që është këtu prezent dhe që ka qenë vazhdimisht, është drejtori Afrim Oruqi. Kërkoj nga nënkryetari që mbledhjet e KPF-së të mos neglizhohen në këtë formë, sepse duhet ta ndiejnë përgjegjësinë dhe të marrin pjesë këtu.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për këmbimin e pronave komunale me pronat e institucionit qëndror:

Kryesuesi: Kjo pikë veçse u prezantua në fillim nga drejtori. Shpresojmë që materiali të bëhet gati dhe ta keni në emailt tuaja. Nëse nuk kemi diçka tjetër, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash, votohet edhe pika e fundit. Me kaq, e kemi përfunduar për sot. Ju falënderoj për vëmendjen!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi



KRYESUESI:

Arbër Zenuni

